



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2020:178569
Datë: 25.02.2021
Numri i dokumentit: 01542778

P.nr.1021/2020

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN-Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, përmes gjyqtarit të vetëm gjykues Sabedin Mushica, në çështjen penale kundër të akuzuarit A. B nga fshati, Komuna e Novobërdës, për shkak të veprave penale të vjedhjes nga neni 313 paragrafi 1 lidhur me nenin 31 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, (KPRK-ës)¹, të cilën sipas detyrës zyrtare e mbron av.Kaqusha Avdiu nga Gjilani, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan me numër PP.II.nr.2126/2020, të datës 22.12.2020, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar dhe publik, më datë 29.12.2020, i shpallur me datë 30.12.2020, i përpiluar me datë 29.01.2021, këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari A. B nga babai S., nëna Xh., e lindur H., i lindur me datë ... në Gjilan, me vendbanim në fshatin Komuna e Novobërdës, i martuar, ka të kryer 7 vite të shkollës fillore, i papunë, i gjendjes së varfër ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

I

Me datë 02.12.2020 rreth orës 18:14min, në Gjilan, në rrugën “.” i akuzuari A. B me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm pasuror për vete apo përsonin tjetër në bashkëveprim me N.A, kanë vjedhur në shitoren “B.M...”, në atë mënyrë që shkojnë në shitore, hyjnë brenda e me të arritur në sektorin e higjienës aty e marrin 10 (dhjetë) copë deodorant të firmës “A...” në vlerë totale prej 20 euro, me ç’rast pasi të dyshuarit e kryejnë vjedhjen secili i merr nga 5 copa deodorant, e më pas në rrugë u’a shesin kalimtarëve të rastit dhe në këtë mënyrë tani të dëmtuarit A. A, i shkaktojnë dëm në vlerë prej 20 euro.

II

¹ Kodi Penal i Republikës së Kosovës (Në tekstin e mëtejme KPRK), nr.06/L-074, i datës 23 nëntor 2018, i cili ka hyrë në fuqi më 14 prill 2019.

Me datë 06.12.2020 rreth orës 15:05min, në Gjilan, në rrugën “”, i pandehuri A. B, me qëllim të përfitimit të kunderligjshëm pasuror per vete apo per personin tjetër, ne bashkëveprim me M.T i cili gjendet në arrati kanë kryer vjedhje në shitoren “B...” në ate menyre qe shkojne në shitore, hyjnë brenda duke i'u shkamngur punëtorëve te marketit, arrine në sekordin e higjës me që rast arrine të marrin 4 cope deodorant te firmes “A...” ne vlere totale prej 8 euro, dalin nga marketi e pasaj ne rruge ia shesin kalimtarëve te rastit ddhe ne këtë menyre tani te demtuares L. S i shkaktojne dëmë për vleren e lartcekur.

III

Mes datës 04 - 07.12.2020 në intervalin kohor 17:00 – 17:30min në Gjilan, në Gjilan, në rrugën e Prishtinës, i akuzuari A. B me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm pasuror per vete apo për personin tjetër, ka kryer vjedhje në shitoren “T...”, në atë mënyrë që shkon në shitore , hynë e me të arritur në sektorin e ushqimit te frizat merr 10 pako të mishit të llojit përshutë, i fsheh duke i futur ne bel, e më pas largohet nga shitorja, me ç’rast tani të dëmtuarit R. A, i shkakton dëm në vlerë të pa përcaktuar.

IV

Me datë 07.12.2020, rreth orës 14:54min, në Gjilan, në rrugën “”, i akuzuari A. B me qëllim të përfitimit të kunderligjshëm pasuror për vete apo për përsenin tjetër në bashkëveprim me M. T, i cili gjendet në arrati, kanë kryer vjedhje në shitoren “”, në atë mënyrë qe shkojnë në shitore, hyjnë brenda duke ju shamngur punëtorve të marketit arrijnë në sektorin e ushqimit te frizat, me ç’rast arrijnë të marrin 2 (dy) pako mish të llojit pershutë dhe në këtë mënyrë tani të dëmtuarit A. i shkaktojnë dëm në vlerë të pa përcaktuar.

-Me çka ka kryer, veprën penale vjedhje në vazhdimësi nga neni 313 paragafi 1 lidhur me neni 31dhe 77 të KPRK-ës.

Andaj, gjykata në bazë të nenit 4, 38, 39, 40, 42, 43, 69, 70, 71, 72 dhe 77 të KPRK-ës, lidhur me nenin 248 dhe 365 të Kodit të Procedurës Penale(KPP-ës)², të akuzuarin e lartcekur:

E GJYKON

Me dënim me burgim, në kohëzgjatje prej 1(një) viti dhe me dënim me gjobë në shumë prej 400(katërqind) euro, të cilat dënime do të ekzekutohen në afat prej 15 ditëve, pasi që ky aktgjykim të merr formën e prerë.

² Kodi i Procedurës Penale (Në tekstin e mëtejme KPP), nr.04/L-123, i datës 13 dhjetor 2012, i cili ka hyrë në fuqi më 1 janar 2013.

Nëse i akuzuari nuk dëshiron ose nuk është në gjendje të paguajë dënimin me gjobë, atëherë të akuzuarit dënimi me gjobë do të zëvendësohet në dënim me burgim, në atë mënyrë që për çdo 20€(njëzet)euro, do të caktohet një ditë burgim.

Palët e dëmtuara A. A, R. A dhe A. A që të tre nga Gjilani, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontest të rregullt juridiko-civil.

Koha e kaluar ne paraburgim edhe ata nga data 16.12.2020 e deri më 30.12.2020, do të llogaritet në dënimin e shqiptuar me burgim.

Masa e paraburgimit e caktuar me Aktvendimin e kesaj gjykate PPr.nr 241/20 të datës 17.12.2020, i ndërprehet me datë 30.12.2020.

Detyrohet i akuzuari që të paguajë paushallin gjyqësor në shumën prej 30€(tridhjetë) euro si dhe shumën prej 30€(tridhjetë) euro, në emër të kompensimit e viktimave të krimit, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë, nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm.

A R S Y E T I M

1.Rrjedha e çështjes

Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, me datë 23.12.2020, në këtë gjykatë ka dorëzuar aktakuzën me numër PP.II.nr.2126/2020 e datës 22.12.2020, kundër të akuzuarit A. B nga fshati, Komuna e Novobërdës për shkak të 4 veprave penale të vjedhjes nga neni 313 paragrafi 1 lidhur me paragrafin 31 të KPRK-ës.

Me datë 29.12.2020, gjykata ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar në të cilën kanë prezantuar prokurorja e shtetit L. K, i akuzuari A. B, me mbrojtësen e tij avokat Kaqusha Avdiu, në të cilën seancë i akuzuari pas leximit të akt akuzës nga ana e prokurores, ka deklaruar se e ka kuptuar në tërësi aktakuzën dhe veprat penale për të cilën akuzohet dhe se e pranon fajësinë për kryerjen e këtyre veprave penale.

2.Vlerësimi i pranimin të fajësisë

Gjykata pas dëgjimit të palëve ka marrë aktvendim me të cilin ka pranuar fajësinë e të akuzuarit për veprën penale për të cilën akuzohet ngase ka konstatuar se janë plotësuar gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë në kuptim të nenit 248 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1, 1.2, 1.3 dhe 1.4 të KPP-ës.

Në këtë aspekt gjykata ka konstatuar se i akuzuari e ka kuptuar drejtë natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht, se i akuzuari nuk ka qenë i detyruar ose i shtrënguar në asnjë mënyrë që të pranojë fajësinë, se pranimi i fajësisë mbështet në faktet e çështjes të cilat i përmban aktakuza dhe se aktakuza nuk përmban ndonjë shkelje ligjore e as gabime faktike.

3.Vendimi lidhur me rikualifikimin juridik të veprës penale.

Prokuroria Themelore në Gjilan ka ngritur aktakuzë edhe atë për 2 vepra penale vjedhje nga neni 325 paragrafi 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-ës dhe 2 vepra penale të vjedhjes nga neni 325 paragrafi 1 të KPRK-ës.

Gjykata ka vlerësuar se pretendimet e prokurorisë në raport me përshkrimin faktik të ngjarjes në aktakuzë dhe kualifikimit juridik të veprës penale. Të gjitha këto në raport me nenin 360 të KPP-së.

Andaj, Gjykata nuk detyrohet me propozimet e prokurorit të shtetit lidhur me kualifikimin ligjor të veprës penale, ashtu që në këtë rast ka ndryshuar vetëm kualifikimin juridik të veprës penale edhe **atë të veprës penale në vazhdim**, ngase duke marrë parasysh se veprat penale janë kryer në një periudhë të afërt kohore, edhe atë gjatë muajit dhjetor të vitit 2020 (**ku në dispozitivat e aktgjykimit përfshihen datat edhe atë 02.12.2020, 06.11.202, 04-07.12.2020 dhe 07.12.2020**), objektet e veprës penale kanë qenë pothuajse të njëjta, dashja e kryesit ka qenë e njëjte edhe atë përfitimi i kundërligjshëm pasuror, kushte këto të paraparë në nenin 77 të KPRK-ës, andaj nga këto të lartcekurat gjykata ka vendosur që ta ri kualifikojë veprën penale në vjedhje në vazhdim, ashtu sic është përshkruar në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

4.Gjendja faktike e vërtetuar

Duke u bazuar në të lartcekurat, gjykata vërtetoi këtë gjendje faktike: se i akuzuari A. B e ka kryer veprën penale, të vjedhjes në vazhdim nga neni 313 paragrafi 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-ës, ashtu sic janë përshkruar në pikat I, II, III dhe IV të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

5.Vendimi për shpalljen fajtor

Duke u bazuar në këto që u cekën më lartë, gjykata ka vendosur që të akuzuarin, ta shpall fajtor për kryerjen e veprave penale sipas dispozitivit të këtij aktgjykimi, ngase veprimet e të njëjtit i përmbajnë të gjitha tiparet e këtyre veprave penale dhe se për të njëjtin është penalisht përgjegjës.

6.Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Gjykata, me rastin e shqiptimit të dënimit me burgim unik në kohëzgjatje prej 1(një) viti si dhe me dënim me gjobë në shumë prej 400€, ka konsideruar se duke i marrë parasysh të gjitha rrethanat dhe provat të cilat gjinden në shkresat e lëndës ky dënim do të jetë i drejtë dhe në harmoni me peshën e veprës penale.

Gjykata, me rastin e matjes së dënimit ka marrë për bazë edhe rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit duke u bazuar në nenet 69, 70 dhe 72 të KPRK-së, ashtu që për të akuzuarin si rrethanë lehtësuese ka marrë faktin se i njëjti ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet, ka shprehur keqardhje për rastin që ka ndodhur si dhe i ka premtuar gjykatës që më nuk do të bie ndesh me ligjin, ndërsa si rrethanë rënduese gjykata mori shkallën e përgjegjësisë penale të kryesit, intensitetin e rrezikimit apo dëmtimit të vlerës së mbrojtur, motivin për kryerjen e kësaj veprë penale, rrethanat nën të cilat është kryer vepra penale, qëllimin.

7.Shqiptimi i dënimit në harmoni me peshën e veprës penale dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të pandehurit dhe qëllimi i dënimit të shqiptuar

Sipas bindjes së gjykatës dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarit të lartcekur, duke i marr parasysh rrethanat e lartpërmendura është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale, me mënyrën e kryerjes së veprës penale si dhe shkallën e përgjegjësisë të akuzuarit.

Gjykata po ashtu ka konstatuar se me këtë dënim mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit nga neni 38 të KPRK-së, i cili konsiston në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale dhe rehabilitimin e tij, parandalimin e personave të tjerë nga kryerja e veprave penale, shprehja e

gjykimit shoqëror për veprën penale dhe ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

8.Llogaritje e paraburgimit në dënimin e shqiptuar

Në 79 paragrafi 1 të KPRK-ës parashihet se “*Koha e kaluar në paraburgim, arrest shtëpiak si dhe çdo periudhë e heqjes së lirisë lidhur me veprën penale llogariten në dënimin e shqiptuar me burgim dhe me gjobë*”, andaj në rastin konkret i akuzuari i lartcekur, ka qëndruar nën masën e paraburgimit edhe atë nga data 16.12.2020 deri më datë 30.12.2020, ashtu që një ditë e qëndrimit në masën e paraburgimit do ti llogaritet në dënimin e shqiptuar me burgim, si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

9.Zëvendësimi i dënimit me gjobë

Duke u bazuar në nenin 46 paragrafi 3 të KPRK-së nëse i akuzuari refuzon të paguajë dënimin me gjobë ose nuk është në gjendje ta paguaj atë atëherë dënimi me gjobë do të zëvendësohet në dënim me burgim në atë mënyrë që për çdo 20 € (njëzet euro) do ti caktohet një ditë burgim efektiv.

10.Vendimi për realizimin e kërkesës pasurore juridike

Gjykata, të dëmtuarit: A. A, R. A dhe A. A që të tre nga Gjilani për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontest civil konfrom nenit 463 të KPP-ës.

11.Vendimi mbi shpenzimet procedurale.

Duke pasur parasysh natyrën e kësaj çështje penale, gjykata duke u bazuar në nenin 451 paragrafi 1 të KPP-ës, ka vendosur që të akuzuarin ta obligojë të paguajë paushallin gjyqësor në shumën prej 30€ si dhe shumën prej 30€, për kompensimin e viktimave të krimit, në afat prej 15 ditëve pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

Andaj duke u bazuar në të lartcekura, gjykata vendosi si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
P.nr.1021/2020,
Me 29 Janar 2021

Gjyqtari i vetëm gjykues,
Sabedin Mushica

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i dorëzohet kësaj Gjykate Themelore.